

WORKSHOP

Përgatitja e Strategjisë së Zhvillimit Vendor për zonën LEADER të GVV Kolonja e Gjelbër

Finalizimi i planit të veprimit

7 shtator 2023, ora 10:30, Salla e Bibliotekës, Ersekë

ANRD fton anëtarët e Grupit Vendor të Veprimit Kolonja e Gjelbër në workshopin e tretë që fokusohet në finalizimin e planit të veprimit për strategjinë e zhvillimit vendor, që do të zhvillohet në ambjentet e Bibliotekës së qytetit.

Takimi fillimisht do prezantojë situatën e deritanishme me planin e veprimit për çdo fushë prioritare të përzgjedhur. Më pas, anëtarët e GVV-së të ndarë në grupe pune sipas tematikave do të diskutojnë dhe ofrojnë input për finalizimin e planit të veprimit duke përfshirë plotësimin e masave/ndërhjerve për çdo objektiv specifik, validimin e lidhjeve të masave dhe objektivave përkatëse, treguesit e rezultateve, përcaktimin e përgjegjësisë dhe afatet kohore për zbatimin si dhe kostot përkatëse për zbatimin e çdo mase.

ANRD do të ofrojë udhëzimet metodologjike dhe formatet që do të lehtësojnë punën në grupe.

Programi

10:30 – 10:35 | Hapja e workshopit, prezantimi i qëllimeve dhe pritshmërive

10:35 – 10:45 | Prezantimi i planit të veprimit bazuar në kontributin e workshopit të mëparshëm

10:45 – 11:45 | Punë në grupe sipas tematikave për të plotësuar planin e veprimit me masat dhe ndërhjert dhe për të përcaktuar indikatorët për çdo masë/ndërhjert të parashikuar

11:45 – 12:00 | Pushim kafeje/ refreshments

12:00 – 12:20 | Planifikimi i kostove për çdo masë/ndërhjert

12:20 – 13:00 | Prezantimi dhe orientimi për plotësimin e formatit të zhvillimit të koncept idesë dhe ndarja e përgjegjësisë mes anëtarëve për të zhvilluar koncept idenë për projekte të caktuara.

13:00 | Përfundimi i takimit

Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural, në rolin e nënkontraktorit, po zbaton projektin “Fuqizimi i Grave në zonat Rurale dhe Turizmi” së bashku me UN Women Albania, të financuar nga Qeveria Italiane dhe në partneritet me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.